




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

FTESË PËR OFERTË

NR. I PROT.TË FTESES PER OFERT	657
DATA E PUBLIKIMIT	03.08.2016
DATA E MBYLLJES	16.08.2016
TITULLI I KONTRATES	MARRJE ME QIRA E HAPËSIRAVE PER PUNË
AUTORITETI KONTRAKTUES	KOMUNA E GJILANIT
ADRESA:	

Drejtuar: Subjekteve private dhe juridike

1. Komuna e Gjilanit në Gjilan po kërkon oferta nga pronarët privat dhe juridik të pasurive të paluajtshme (objekteve) për marrjen me qira të ambienteve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ftesë për ofertë.
2. Komuna ka për qëllim të lidh një kontratë qiraje për një afat që do të caktohet me marrëveshje në kontratë.
3. Duke paraqitur një ofertë, propozuesi pranon plotësisht dhe pa asnjë kufizim kërkesat e kësaj ftese për ofertë, si baza e vetme e këtij procesi dhe heq dorë nga çdo kusht i tij, pavarësisht llojit të kushtit.

Udhëzime për paraqitjen e propozimeve

Të përgjithshme

4. Propozuesit duhet të paraqesin një ofertë që i përgjigjet drejtpërdrejtë kushteve të kësaj ftese për ofertë. Propozuesit duhet të përfshijnë informacione të detajuara që tregojnë përmbushjen e kërkesave, afateve dhe kushteve të kësaj ftese për ofertë.
5. Kjo ftesë për ofertë, do të jetë pjesë e kontratës së qirasë që mund të lidhet me propozuesin në vijim të kësaj ftese për ofertë.

Formati i propozimeve

5. Propozimi duhet të paraqitet në dy pjesë të ndara, pjesa teknike dhe pjesa financiare.
6. Propozimi teknik duhet të trajtojë të gjitha kushtet kualifikuese të kësaj Ftese për ofertë dhe duhet të përfshijë modele, shembuj dhe foto të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në këtë ftesë për ofertë. Niveli i detajeve praktike të ofruara do të jetë shumë i rëndësishëm në vlerësimin e ofertës.

Propozimi teknik nuk duhet të përmbajë ndonjë informacion mbi çmimin e ofruar ose kostot.

7. Propozimi financiar duhet të përmbajë informacion të saktë mbi çmimin e qirasë duke përfshirë edhe çdo kosto tjetër që ka lidhje me qiranë. Gjithashtu, Propozuesit mund të përcaktojnë nëse çmimi i ofruar është i negociueshëm ose jo.

Secila pjesë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

7. Propozimi teknik

Propozimi teknik duhet të përfshijë:

1. Përshkrim i përgjithshëm i subjektit privat/juridik që ka në pronësi objektin.
2. Certifikata e regjistrimit të shoqërisë si dhe kopjen e letërnjoftimit të pronarit. Në rastin e individëve, propozimi mund të përfshijë vetëm kopjen letërnjoftimit të pronarit të pasurisë.
3. Një përshkrim i ambienteve që propozohen të jepen me qira:
 - 3.1. Dokumentet që provojnë pronësinë mbi objektin që propozohet të jepet me qira;
 - 3.2. Fotografji të objektit kohëve të fundit dhe të zonës përreth, ambienteve, zonës së parkimit apo garazhit;
 - 3.3. Plan vendosja;
 - 3.4. Viti i ndërtimit të objektit, si dhe viti i rinovimit, në rast se është rinovuar;
 - 3.5. A ka nevojë për renovim, a posedon rrymën elektrike, ujësjellësin kanalizimin, ventilim, nxehje qendrore dhe internetin etj.
 - 3.6. Planet e kateve dhe të zyrave (përshkruaj numrin e zyrave m² të zyrave të sallave etj.
 - 3.7. Datën e mundshme të fillimit të qirasë.

Çdo e dhënë tjetër që mund të jetë e nevojshme për përshkrimin e shërbimeve të ofruara.

Ju lutem vini re që propozimi teknik nuk duhet të përmbajë ndonjë informacion mbi çmimin e ofruar ose kostot.

8. Propozimi financiar

Çmimi jepet për metër katror. Çmimi duhet të jetë i arsyeshëm, i pranueshëm në bazë të kushteve të tregut dhe i negociuar.

Vlerësimi i propozimeve

9. Si rregull i përgjithshëm, vetëm ofertat që janë teknikisht të pranueshme dhe që paraqesin të gjitha dokumentet teknike sipas përcaktimit të kësaj ftese për ofertë do të merren në konsideratë për vlerësimin e ofertës financiare. Propozimet teknike duhet të përmbushin të paktën **70%** të kriterëve me qëllim që të merret për vlerësim oferta financiare.

Vendimi për përzgjedhjen e një oferte do të bazohet në një kombinim të kriterëve teknike dhe financiare dhe negociatat me palën propozuese për çmimin e qirasë.

Data

10. Komuna e Gjilanit ka si qëllim të vendoset në zyrat e reja menjëherë pas përfundimit të procedurës dhe afateve të caktuara në këtë ftesë ofertë. Kohëzgjatja e kontratës caktohet me marrëveshje.

Periudha e vlefshmërisë së propozimit

11. Propozimet dhe çdo ofertë financiare është e vlefshme jo më shumë se 30 ditë nga data e fundit e paraqitjes së ofertave.

Paraqitja e ofertave

12. Propozimet duhet të futen në një zarf të mbyllur. Zarfet që përmbajnë propozimin teknik dhe financiar duhet të futen brenda një zarfi tjetër, i cili duhet të ketë shënimet e mëposhtme.

13. Propozimet e dërguara në ndonjë adresë tjetër mund të refuzohen.

14. Propozimet duhet të mbajnë datën, emrin e ofertuesit, adresën dhe duhet të nënshkruhen nga një përfaqësues i autorizuar i propozuesit.

15. Ju lutem vini re që kushtet e kësaj ftese për ofertë do të jenë pjesë e kontratës që mund të lidhet me ofertuesin e përzgjedhur. Për këtë qëllim, kontrata do të kërkojë që propozuesi të plotësojë të gjitha deklaratimet që ka bërë në ofertë.

16. Autoriteti kontraktues nuk obligohet që të lidh kontratë me asnjë ofertues varësisht plotësimin të kushteve.

Afati i paraqitjes së ofertave

Afati i publikimit të kësaj ftese për ofertë do të jetë 14 ditë nga dita e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kushtet kualifikuese

KËRKESAT TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Vendndodhja: Gjilan, Zyrat duhet të ndodhen jo më shumë se 800m larg me rrugë nga qendra e qytetit (Selia e komunës).
2. Zyrat duhet të kenë qasje në rrugën kryesore të qytetit ose jo ma larg se 150m.
3. Punonjësit dhe qytetarët duhet të arrijnë lehtësisht zyrat nëpërmjet transportit publik.
4. Objekt më vehte Në përgjithësi duhet të jetë një objekt i mirëmbajtur, i ndërtuar me materiale ndërtimi cilësore.
5. Të ketë hapësira të mjaftueshme për parkime të veturave zyrtare dhe për qytetarë (nuk llogariten në çmim).
6. Hapësira totale që do të merret me qira: nga 1400 deri në 1500m² ose minimum 1400m².
 - 6.1. Hapësirat duhet të jenë të përshtatshme për vendosjen e përafërsisht 30/30 vende pune:
 - 6.2. Sallë Mbledhjesh (minimum. 1x15-20 m²).
 - 6.3. 9 hapësira punuese me nga 20m²,
 - 6.4. 2 hapësira punuese me nga 40m²,
 - 6.5. 1 hapësirë punuese me 200m²,
 - 6.6. 1 hapësirë punuese me 60m²,
 - 6.7. Tualete (min. 2-4 për meshkuj dhe për femra)
 - 6.8. Korridore të përshtatshme në funksion të ambienteve të mësipërme.
7. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet: Objekti duhet të jetë i lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve të qytetit si dhe duhet të ketë akses të rregullt në shërbimin e mbledhjes së mbeturinave.
8. Të posedojë ngrohjen dhe ftohjen. Sistemi i kondicionimit i pavarur.
9. Ndriçimi: drita e diellit (duhet të ketë një numër të përshtatshëm dritaresh që të lejojë dritën natyrale) dhe ndriçim elektrik të përshtatshëm, ndriçim natyral të përshtatshëm për hyrjet, perimetrit dhe parkimet.
10. Hapësirë e përshtatshme për Serverin me sistem kabllor: dhomë e dedikuar me sistem të përshtatshëm për ftohjen, ventilimin dhe kondicionimin e ajrit.
11. Dyert dhe dritaret: të sigurta dhe të qëndrueshme ndaj motit; duhet të përmbushin kërkesat për mbrojtjen nga të ftohtit dhe zjarri.
12. Ndërtesa duhet të jetë gati për t'u përdorur menjëherë.
13. Ruajtje të objektit me shërbim të ruajtjes dhe sigurisë fizike 24 orë.
14. Hyrje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.

Formati i çmimit

Çmimet paguhen për çdo muaj

Nr.	Lloji	Sasia	Njësia (m ² neto)	Çmimi për njësi për muaj	Çmimi total për muaj
1	Zyrat		m ² neto		
2	Ambientet e përbashkëta dhe hapësira tjera		m ² neto		
3	Parkimi		m ² neto	//	//
	TOTAL:				

Për parkingje nuk caktohen çmime.

Kushtet e pagesës: sipas marrëveshjes ne kontratë

Nënshkrimi i propozuesit: _____

Data: _____